



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA DURRËS**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr. 19, datë 31.03.2022

**PËR**

**MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË ANEKSIT NR. 2, 4, 5, TË VKB-SË NR.74, DATË 24.07.2020 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 1, 3, 4, 6, SUKTH DHE ISHËM, BASHKIA DURRËS” PËRSA I PËRKET NDRYSHIMIT TË LISTAVE EMËRORE TË FAMILJEVE PËRFITUESE TË GRANTIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT E DËMTUARA SI PASOJË E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019, PËR SHKAK TË NDRYSHIMIT TË KATEGORISË SË DËMIT**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Aktit Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” miratuar me Ligjin nr.97/2019, VKM-së nr. 750, datë 27.11.2019, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë”, VKM-së nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model” i ndryshuar, VKM-së nr.904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e subjekteve përfituese nga disa programe të procesit të rindërtimit” i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës” i ndryshuar, dhe sipas relacionit të hartuar nga Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Bashkinë Durrës, me propozim të Kryetares së Bashkisë,

**KËSHILLI BASHKIAK**  
**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të Aneksit 5 “Subjektet përfituese të grantit të rindërtimit, Njësia Administrative nr.4”, bashkëlidhur VKB-së Nr.74, datë 24.07.2020 “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative nr.1,3,4,6, Sukth dhe Ishëm, Bashkia Durrës”, përsa i përket ndryshimit të kategorisë së dëmit të listës së familjeve përfituese nga programi i procesit të rindërtimit e detajuar sipas tabelës, pjesë përbërëse e këtij vendimi, si më poshtë vijon:

NR.	APLIKIM	EMËR	ATËSIA	MBIEMËR	EKSPERTIZA E THELLUAR	SUBJEKT PËRFITUES
4	13987	NDUE	GJON	JAKU	DS4	PO
8	25451	EQEREM	XHEVAHIR	DURBAKU	DS4	PO

2. Heqjen nga lista e përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësinë Administrative nr.1, 3, 4, 6, Sukth dhe Ishëm, të dëmtuara si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019”, Aneksat 2 dhe 4 pjesë e VKB-së nr.74, datë 24.07.2020, të subjekteve si më poshtë vijon:

ANEKSI	NR.RENDOR	EMËR	MBIEMËR	DS	KONKLUZIONI AKTEKSPERTIZËS	VKB FITUESE	NJËSIA
2	1	DRITA	TANUZI	DS4	DS5	Nr. 74, datë 24.07.2020	NR.1
4	1	ILIA	ARONI	DS4	DS5	Nr. 74, datë 24.07.2020	NR.3

3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

**KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ani Dyrmishi**



**U shpall sot me datë 04.04.2022**




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 2046 prot.

Durrës, më 14.04.2022

**Lënda:** Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK  
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.19 datë 31.03.2022 “Për miratimin e ndryshimit të Aneksit Nr 2,4,5 të VKB Nr 74 dt 24.07.2020” Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i rindërtimit në Njësitë Administrative Nr 1,3,4,6 Sukth dhe Ishëm Bashkia Durrës” përsa i përket ndryshimit të listave emërore të familjeve përfituese të grantit të rindërtimit për banesat e dëmtuara si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019, për shkak të ndryshimeve të kategorisë së dëmit.”

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

